

MBROJTJA NGA FATKEQËSITË PËR TË GJITHË:

Një Qasje që i Përgjigjet Çështjeve
Gjinore dhe Përfshin Personat me
Aftësi të Kufizuar Për Zvogëlimin e
Riskut nga Fatkeqësitë.



Botuar nga Sekretariati i OSBE-së/Programi për
Çështjet Gjinore në kuadër të projektit “WIN – Gratë
dhe Burrat që Gjejnë Mënyra Novatore dhe Lidhen në
Rrjete Për të Siguruar Barazinë Gjinore”.

AUTORËT:
Anna Palonka dhe Bella Evidente
equality@osce.org
www.osce.org/secretariat/gender

Fotografia e kopertinës: *Adobestock, MotionArray (pages 1, 5, 11, 14, 23)*

Programi i OSBE-së për Çështjet Gjinore punon drejt zbatimit të Planit të Veprimit të OSBE-së të vitit 2004 për Promovimin e Barazisë Gjinore dhe vendimeve përkatëse të Këshillit Ministror. Ai mbështet përpjekjet sistematike për të integruar barazinë gjinore në të gjithë Organizatën në të gjitha politikat, programet, projektet dhe aktivitetet e saj në tre dimensionet e sigurisë gjithëpërfshirëse, përkatësisht politiko-ushtarake, ekonomike dhe mjedisore e njerëzore.

Në kuadër të projektit të tij gjithëpërfshirës shumëvjeçar “**WIN - Gratë dhe Burrat që Gjejnë Mënyra Novatore dhe Lidhen në Rrjete Për të Siguruar Barazinë Gjinore**”, Programi i Çështjeve Gjinore po përpqet të avancojë barazinë gjinore si një parakusht për arritjen dhe ruajtjen e shoqërive të qëndrueshme, të begata dhe paqësore në zonën e OSBE-së, në përputhje me Planin e Veprimit të vitit 2004 dhe angazhimet e tjera të OSBE-së.

Informacioni, pikëpamjet, opinionet dhe konkluzionet e paraqitura në këtë dokument nuk ofrohen dhe as nuk mbështeten detyrimisht nga OSBE-ja, përveç nëse shprehimisht deklarohet ndryshe.

PËRMBAJTJA

<u>Hyrja.....</u>	<u>4</u>
<u>Boshllëqet dhe barrierat.....</u>	<u>5</u>
<u>Boshllëqet (Çfarë mungon?).....</u>	<u>5</u>
<u>Barrierat (Çfarë bëhet pengesë?).....</u>	<u>6</u>
<u>Mundësitë dhe veprimet e rekomanduara.....</u>	<u>9</u>
<u>Të Kuptojmë Riskun që Vjen nga Fatkeqësitë.....</u>	<u>10</u>
<u>Të Forcojmë Qeverisjen e Riskut nga Fatkeqësitë.....</u>	<u>11</u>
<u>Të Investojmë në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për Qëndrueshmëri.....</u>	<u>15</u>
<u>Të Rrisim Gatishmërinë ndaj Fatkeqësive dhe Të Rindërtojmë më Mirë.....</u>	<u>18</u>
<u>Shtojcat.....</u>	<u>21</u>
<u>Burimet /Paketat e Mjeteve/Manualet.....</u>	<u>21</u>
<u>Kornizat dhe Politikat.....</u>	<u>25</u>
<u>Platformat Rajonale.....</u>	<u>27</u>
<u>Fjalorth.....</u>	<u>28</u>

HYRJE

Fatkeqësitë dhe rreziqet janë një kërcënim i madh për të gjithë, qofshin këto të shkaktuara nga fenomene natyrore apo nga njerëzit. Megjithatë, pabarazitë shoqërore i bëjnë disa prej nesh më të cenueshëm ndaj efekteve të tyre të dëmshme se sa të tjerët. Gjinia dhe aftësia e kufizuar janë dy faktorë që ndikojnë në cenueshmërinë. Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara janë vazhdimisht të nënpërfaqësuar në politikëbërje, trajnime për gatishmërinë e komunitetit dhe menaxhimin e krizave. Kjo do të thotë se perspektivat e rëndësishme rrezikojnë të anashkalohen në fazat e ndryshme të DRR-së. Ne kemi nevojë për një qasje më gjithëpërfshirëse për të rritur qëndrueshmërinë midis të gjithë njerëzve.

Një sërë kornizash kryesore ndërkombëtare dhe angazhime globale njohin nevojën për të promovuar përfshirjen e aftësisë së kufizuar dhe reagimin, rimëkëmbjen, rehabilitimin dhe rindërtimin ndaj barazisë gjinore dhe fatkeqësive universalisht të aksesueshme. Ato përfshijnë Kornizën Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, SDG-të, Marrëveshjen e UNFCC-së të Parisit për Ndryshimet Klimatike, dhe rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 37 (2018) të CEDAW-it mbi dimensionet që lidhen me gjininë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në kontekstin e ndryshimeve klimatike. Një listë gjithëpërfshirëse e kornizave dhe angazhimeve ndërkombëtare dhe rajonale me një përshkrim për secilin mund të gjendet në faqen 16.

Vendimi 6/14 i Këshillit Ministror të OSBE-së për Rritjen e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë njih rëndësinë e DRR-së që i përgjigjet gjinisë dhe përfshirjes së aftësisë së kufizuar si dhe inkurajon Shtetet pjesëmarrëse që (...)

“të përfshijnë njohuritë dhe informacionin vendor në planet kombëtare, duke marrë parasysh aftësitë si të burrave edhe të grave dhe dobësitë specifike të fëmijëve, grave, të moshuarve, të varfërve dhe personave me aftësi të kufizuara, dhe të angazhojë në mënyrë aktive të gjithë palët e interesuara përkatëse, duke përfshirë aty ku është e përshtatshme autoritetet lokale, shoqërinë civile, sektorin privat, median dhe botën akademike në të gjitha fazat e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë (...).”

Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj DRR-së duhet t'i përgjigjet nevojave dhe dobësive të të gjitha grupeve sociale përmes veprimeve adekuate dhe të përshtatura. Kjo kërkon:

- qeverisje dhe politikëbërje që t'u përgjigjen çështjeve gjinore dhe të përfshijnë aftësinë e kufizuar;
- programim, monitorim dhe vlerësim që t'u përgjigjen çështjeve gjinore dhe të përfshijnë aftësinë e kufizuar;
- integrim të gjinisë dhe aftësisë së kufizuar në vlerësimet e cenueshmërisë, riskut dhe kapacitetit;
- mbledhje dhe përdorim të informacionit dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar;
- lehtësim dhe shfrytëzim të kontributeve dhe udhëheqjes aktuale dhe potenciale të grave dhe personave me aftësi të kufizuara në ndërtimin e qëndrueshmërisë; dhe
- promovim të pjesëmarrjes, udhëheqjes dhe zërit të tyre në proceset e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.




BOSHLLËQET DHE BARRIERAT

Shumë qeveri kanë theksuar rëndësinë e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, rimëkëmbjes dhe ndërtimit të paqes në përgjigje të çështjeve gjinore dhe të përfshirjes së aftësisë së kufizuar në politikat dhe kornizat e tyre kombëtare dhe disa praktika të mira po dalin në pah. Megjithatë, boshllëqet dhe barrierat serioze vazhdojnë. Këto janë shumë të ndryshme, në varësi të kontekstit, qasjes dhe burimeve. Sfidat kyçe lidhen me detyrën e kalimit të prioriteteve

gjithëpërfshirëse të strategjive dhe kornizave globale, rajonale dhe kombëtare në nivel lokal dhe zhvillimin e zgjidhjeve praktike që u shërbejnë individëve dhe komuniteteve në ndërtimin e gatishmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre.

Një vlerësim i kornizave dhe politikave ekzistuese për DRR-në në zonën e OSBE-së zbulon boshllëqet dhe barrierat e mëposhtme në lidhje me përfshirjen e gjinisë dhe aftësisë së kufizuar:



BOSHLLËQET (Çfarë mungon?)

Kuptimi i pamjaftueshëm i cenueshmërisë sistematike dhe ndërsektoriale:

Kur komunitetet konsiderohen kryesisht si homogjene, gratë dhe personat me aftësi të kufizuar janë të ekspozuar ndaj rreziqeve në rritje, pasi i kushtohet vëmendje e pamjaftueshme shqetësimeve dhe nevojave të tyre specifike. Vlerësimet e cenueshmërisë shpesh nuk marrin në konsideratë që individët i përkasin njëkohësisht grupeve të shumta shoqërore dhe ndërsektoriale të cilat përcaktojnë profilin e tyre të riskut dhe identitetin në kontekstin e fatkeqësive.

Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar (SADDD):

Kuptimi i përgjegjësive, nevojave dhe kapaciteteve të ndryshme tek popullata është thelbësor për të identifikuar e zvogëluar fatkeqësitë, për t'u përgatitur për to, dhe për t'u përgjigjur ndaj tyre, duke marrë parasysh rolet gjinore dhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Nevojitet ndërgjegjësim për të kuptuar se si kategori të ndryshme dobësisht kryqëzohen me njera tjetrën.

Mungesa ose qasja e pamjaftueshme ndaj informacionit:

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ato që banojnë në zona rurale dhe rajone të populluara dendur nga pakicat etnike, përballen me barrierat që lidhen me tejkalimin e distancës fizike dhe gjuhës. Personat me aftësi të kufizuara kanë më shumë gjasa të kenë qasje më të dobët në shërbime, njohuri, rrjete komunitare dhe burime të tjera. Implikimet në lidhje me fatkeqësitë janë kërcënuese për jetën: paarritshmëria e bën të vështirë ose të pamundur marrjen e vendimeve të informuara dhe marrjen e veprimeve në kohë dhe të shpejta në përgatitjen dhe reagimin e duhur ndaj fatkeqësive.

Nënperfaqësimi në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes:

Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet (kombëtare, rajonale dhe lokale) prirën të mos jenë as pjesë e proceseve të planifikimit dhe konsultimeve dhe as të përfshihen në zbatimin dhe planifikimin e kontingjentit të gatishmërisë dhe vlerësimet e cenueshmërisë, riskut dhe rrezikut. Planet dhe strategjitë e gatishmërisë për fatkeqësitë, vlerësimet e cenueshmërisë dhe rrezikut, si dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm rrallëherë përfshijnë perspektiva të aftësisë së kufizuar dhe asaj gjinore.

Paaftësia për të integruar çështjet gjinore dhe përfshirjen e aftësisë së kufizuar në politikat, strategjitë dhe planet e veprimit kombëtar dhe lokal të DRR-së:



Ndërsa shumë vende kanë përgatitur tashmë politikat, strategjitë dhe planet e tyre kombëtare dhe lokale të DRR-së, vetëm disa prej tyre kanë integruar përfshirjen gjinore dhe atë të aftësisë së kufizuar. Në shumicën e rasteve, ajo përmendet vetëm në një mënyrë të përgjithshme. Politikat, programet dhe buxhetet janë të informuara në mënyrë të pamjaftueshme për prioritetet specifike të grupeve të prekshme, duke rezultuar në një paaftësi për të adresuar prioritetet kritike dhe mangësitë në zbatim. Pandemia globale e COVID-19 ka zbuluar nevojën për të konsideruar më gjerë ndikimet nga fatkeqësitë, si dhuna me bazë gjinore, diskriminimi dhe pabarazitë. Rimëkëmbja e COVID-19 vazhdon të jetë një prioritet kyç për të gjitha vendet e mbuluara.

Mungesa e ekspertizës për përfshirjen e gjinisë dhe aftësisë së kufizuar në DRR:




Mungesa e ekspertizës në nivel kombëtar ishte një shqetësim i ngritur nga disa pika qendrore të vendit. Edhe nëse ekzistojnë njohuri dhe ekspertizë teknike për përfshirjen gjinore dhe të aftësisë së kufizuar, mund të mos ketë kapacitete të burimeve njerëzore në nivel vendi për ta integruar atë në politikat dhe praktikën e DRR-së.

Mungesa e paralajmërimit të hershëm gjithëpërfshirës:



Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara janë në rrezik më të madh të lëndimit dhe vdekjes për shkak të kufizimeve shoqërore dhe roleve stereotipike, aftësive të kufizuara për shpëtimin e jetës dhe mungesës së qasjes në burime dhe lëvizshmëri. Shpesh gratë nuk kontaktohen me paralajmërim të hershëm ose nuk pranojnë asistencë nga reaguesit e parë që janë burra. Gratë që marrin paralajmërim të hershëm kanë më shumë gjasa të paralajmërojnë të tjerët dhe gratë me fëmijë do të evakujnë nga vendndodhja e tyre më përpara. Ka boshllëqe dhe kufizime në lidhje me mjedisin fizik për proceset e paralajmërimit të hershëm. Parimet dhe procedurat për sigurimin e evakuimit të të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara janë shpesh të papërshtatshme.



BARRIERAT (Çfarë bëhet pengesë?)



Normat dhe paragjykimet shoqërore:

Besimet kulturore dhe praktikrat sociale ndikojnë në faktin se cilat norma, role dhe sjellje janë të pranueshme për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë. Në vendet që karakterizohen nga një shoqëri e fortë patriarkale, gratë perceptohen që të luajnë një rol në familje dhe kryejnë punë shtëpiake, gjë që kufizon pjesëmarrjen e tyre në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Stereotipizimi dhe stigmatizimi mund të çojnë në forma të hapura dhe më delikate të diskriminimit dhe përjashtimit. Ndërhyrjet e DRR-së për barazinë gjinore dhe përfshirjen e aftësisë së kufizuar priren të jenë më të përqendruara në përmirësimin e infrastrukturës fizike, siç është sigurimi i aksesit të karrigeve me rrota në ndërtesa, sesa në mbështetjen sociale.

Pabarazitë në qasjen ndaj programimit të DRR-së:



Gratë, veçanërisht ato të angazhuara në punën e kujdesit në shtëpi dhe gratë shtatzëna, janë më pak të dëgjuara në hartimin e planeve të gatishmërisë për DRR-në. Në mënyrë të ngjashme, personat me aftësi të kufizuara janë zakonisht 'të padukshëm' ndaj operacioneve të gatishmërisë dhe ndihmës, dhe të përjashtuar nga vlerësimet, masat e ndihmës dhe evakuimit. Nevojat e tyre specifike shpesh injorohen.

Angazhimi i pamjaftueshëm i grupeve të pambrojtura në bashkëpunimin dhe partneritetet shumësektoriale dhe me shumë palë të interesuara:



Më së shpeshti, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara nuk janë pjesë e projektimit, planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të kornizave dhe planeve kombëtare të DRR-së. Këto procese priren të përfshijnë specialistë, vendimmarrës dhe praktikues të DRR-së dhe të përjashtojnë aktorët e zhvillimit që punojnë për tema më të gjera dhe ndërsektoriale si barazia gjinore dhe aftësia e kufizuar. Kjo minon zhvillimin e ndërhyrjeve të synuara dhe efektive me një ndikim gjithëpërfshirës.

Struktura dhe koordinimi i dobët institucional për zbatimin, monitorimin dhe raportimin:



Ndërsa DRR-ja gjithëpërfshirëse është një përgjegjësi e përbashkët, struktura institucionale në nivele kombëtare dhe lokale karakterizohet nga prania e shumë ministrive, departamenteve dhe enteve të tjera të angazhuara në aspekte të ndryshme të menaxhimit të fatkeqësive, duke krijuar zona gri përse i përket roleve dhe përgjegjësi. Ekziston një mungesë e një qasjeje të përbashkët dhe bazave të të dhënave dhe sistemeve të integruara për zbatimin, monitorimin dhe raportimin mbi ndërhyrjet gjithëpërfshirëse të DRR-së. Shpeshherë ligjet dhe rregulloret krijohen nga qeveritë kombëtare me informacion të pamjaftueshëm ose me angazhim të pushtetit vendor në pjesën e zbatimit. Aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe joshtetërorë [donatorët, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, organizatat joqeveritare (OJQ-të)] dhe sektori privat priren të punojnë në izolim. Kjo rezulton në dyfishim të përpjekjeve që pengojnë zbatimin e DRR-së gjithëpërfshirëse.

Financimi i pamjaftueshëm për DRR-në gjithëpërfshirëse:



Përfshirja e DRR-së në buxhetet e planifikimit kombëtar dhe miratimi i buxhetimit që i përgjigjet çështjeve gjinore mbeten një sfidë. Shumica e ndërhyrjeve të parashikuara priren të jenë reaktive, duke u përqëndruar në reagimin ndaj fatkeqësive dhe më pak në parandalimin e riskut, gatishmërinë, zvogëlimin e riskut dhe zvogëlimin e nxitësve të riskut. Vëmendje e pamjaftueshme i kushtohet qasjeve parandaluese që adresojnë rrënjët strukturore të dobësive dhe ndërtojnë rezistencën e atyre që janë më të rrezikuara. Gjithashtu, ka interes të kufizuar nga ana e donatorëve dhe institucioneve financiare për të investuar në DRR-në gjithëpërfshirëse.

Raportimi stereotip gjinor në media:



Ka mungesë të kapaciteteve mes profesionistëve të medias për të raportuar mbi DRR-në në një mënyrë të informuar, jo sensacionale e me një përdorim korrekt të terminologjisë së DRR-së që shmang stereotipet gjinore. Tema të tilla si shëndeti riprodhues, qasja ndaj ndihmës, disponueshmëria e ushqimit, cilësia dhe pajisjet e strehimoreve ose siguria e grave në qendrat e pritjes marrin shumë pak mbulim mediatik.

DRR-ja gjithëpërfshirëse e kufizuar në arsim:



Kornizat legjislative kombëtare zakonisht ofrojnë një bazë për planet e evakuimit të shkollave dhe gatishmërinë në raste fatkeqësish që marrin parasysh nevojat e ndryshme të vajzave, djemve, grave dhe burrave. Megjithatë, shumë pak shkolla i përmbahen këtyre rregulloreve dhe shumica dërrmuese e shkollave ose nuk kanë plane shkollore për gatishmëri në raste fatkeqësish ose ato janë të vjetruara dhe jo funksionale. Edhe aty ku ekzistojnë, planet e gatishmërisë për fatkeqësitë dhe rrugët e evakuimit nuk janë përshtatur me nevojat e veçanta të grave, vajzave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Fëmijëve dhe mësuesve nuk u është mësuar se si të mbështesin njerëzit me nevoja të veçanta në raste urgjence.

MUNDËSITË DHE VEPRIMET E REKOMANDUARA

Një përmbledhje e mundësive dhe e veprimeve të rekomanduara për integrimin e politikave dhe menaxhimit të DDR-së në përgjigje të çështjeve gjinore dhe të përfshirjes së aftësisë së kufizuar, të organizuara sipas katër prioritetëve të Kornizës Sendai, jepen në Figurën 1 më poshtë:




Figura 1: Përmbledhje e mundësive dhe rekomandimeve



TË KUPTOJMË RISKUN QË VJEN NGA FATKEQËSITË

Përdorni më mirë të dhënat dhe mjetet gjithëpërfshirëse dhe të SADD-it:

→ Ndërtoni kapacitete dhe burime për të mbledhur dhe përpunuar SADD-in, veçanërisht në qytete dhe bashki më të vogla. Mbledhja e informacionit dhe e të dhënave për popullsinë e prekur kërkon përdorimin e mjeteve të shumta: anketa, pyetësorë, fokus grupe dhe/ose vëzhgime. Të dhënat e ndara për gjininë dhe moshën ndihmojnë në përcaktimin e ekspozimit, cenueshmërisë dhe ndikimit të fatkeqësive dhe krizave në popullatën e prekur, veçanërisht në ato më të rrezikuara. Kjo përfshin rritjen e ndërgjegjësimit bazuar në të dhënat e përmirësuar të ndara që bazohen në moshën, seksin/gjininë, gjendjen ekonomike, përkatësinë etnike, kombësinë, statusin e imigrimit dhe aftësitë e kufizuara. Kjo gjithashtu kërkon gjenerimin e informacionit të riskut të ndarë sipas cenueshmërisë, duke përfshirë bazat e të dhënave të dëmeve dhe humbjeve që lidhen me asetet dhe infrastrukturën fizike, socio-ekonomike dhe të tjera për të përmirësuar politikat.

Rivlerësoni politikat e bazuara në analiza gjinore dhe gjithëpërfshirëse:

→ Identifikoni nevojat praktike dhe strategjike gjinore dhe analizoni shkaqet dhe pasojat e dallimeve midis grave dhe burrave. Interpretoni të dhënat sipas teorive të vendosura sociologjike (ose të tjera) për marrëdhëniet midis grave dhe burrave. Formuloni politika dhe vendime gjithëpërfshirëse. Projektoni ndërhyrje për DRR-në që marrin në konsideratë dhe trajtojnë pabarazitë dhe dallimet midis grave dhe burrave dhe shpërndajnë burime që korrigjojnë pabarazitë ekzistuese gjinore në DRR.

Krijoni bazave të të dhënave kombëtare të humbjeve dhe dëmeve nga fatkeqësitë:

→ Të tilla baza të të dhënave janë jetike për raportimin pasi ato ndihmojnë për të llogaritur dhe pasqyruar më mirë realitetin e humbjeve nga fatkeqësitë e përjetuara nga gratë dhe grupet e tjera shoqërore. Shumica e bazave të të dhënave ofrohen nga qeveritë; disa përdorin formatin e përbashkët DesInventar të ofruar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësive (UNDRR - shih praktikën e mirë më poshtë). Transformimi i të dhënave të rrezikut në informacione të kuptueshme dhe të përdorshme do të kërkojë rritje të bashkëpunimit ndërmjet qeverive vendore dhe qendrore dhe palëve të interesuara, duke përfshirë sektorin privat dhe shoqërinë civile.

Përcaktoni dhe monitoroni treguesit e gjinisë dhe aftësisë së kufizuar:

→ Zhvilloni dhe/ose përditësoni treguesit dhe objektivat për gjininë dhe aftësinë e kufizuar në nivel kombëtar që janë të përshtatura për kontekstin e vendit dhe në përputhje me marrëveshjet globale si Korniza Sendai dhe SDG-të. Kjo do të sigurojë një kuptim më të mirë të rreziqeve dhe dobësive nga fatkeqësitë, do të forcojë bazën dhe do të sigurojë të dhëna në kohë reale për reagim efektiv ndaj fatkeqësive, do të lehtësojë planifikimin gjithëpërfshirës të DRR-së dhe programimin e synuar, dhe do të përmirësojë monitorimin dhe raportimin e progresit.



PRAKTIKA TË MIRA

Baza e të dhënave kombëtare për dëmet dhe humbjet nga fatkeqësitë

Shqipëria, Egjipti, Jordania, Mongolia, Mali i Zi, Maroku, Serbia, Tunizia dhe Turqia janë midis 89 vendeve që kanë një bazë të dhënash kombëtare të formatit DesInventar për dëmet dhe humbjet nga fatkeqësitë. DesInventar është një sistem i menaxhimit të informacionit për fatkeqësitë i ofruar nga UNDRR për mbledhjen, dokumentimin dhe analizën sistematike të të dhënave në lidhje me humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë që lidhen me rreziqet natyrore. Ky mjet ndihmon për të analizuar tendencat e fatkeqësive dhe ndikimet e tyre në një mënyrë sistematike. Me rritjen e të kuptuarit të tendencave të fatkeqësive dhe ndikimeve të tyre, mund të planifikohen masa më të mira parandalimi, zbutjeje dhe gatishmërie për të reduktuar ndikimin e fatkeqësive mbi komunitetet. Softueri DesInventar është i llojit burim i hapur dhe pa pagesë për përdorim komercial dhe jokomercial.

Në Shqipëri, Serbi, Turqi, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, në kuadër të Asistencës së Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit

Evropian (BE), u krijua një platformë e hapur për zhvillimin dhe përmirësimin e bazës së të dhënave kombëtare për humbjet nga fatkeqësitë. Platforma rrit koherencën midis sistemeve dhe metodologjive kombëtare, dhe përputhshmërinë me rregulloret dhe udhëzimet ekzistuese të BE-së.



NORTH MACEDONIA

©OECE



TË FORCOJMË QEVERISJEN E RISKUT NGA FATKEQËSITË

Siguroni politika dhe strategji kombëtare gjithëpërfshirëse:

Përafroni politikat dhe strategjitë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë me qëllimet dhe objektivat e kornizave ndërkombëtare dhe rajonale të DRR-së. Politikat dhe strategjitë kombëtare të DRR-së, duke përfshirë planet dhe programet lokale, duhet të synojnë tek nxitësit e pabarazisë dhe përjashtimit dhe të sigurojnë që nevojat e atyre që janë më të rrezikuara dhe grupeve të marginalizuara të kenë prioritet.





PRAKTIKA TË MIRA

Politikat kombëtare gjithëpërfshirëse

Në **Japoni**, Tërmeti i Madh i Japonisë Lindore i marsit 2011 dhe cunami u hapi rrugën grave që të luajnë një rol aktiv në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, rindërtimin dhe ndërtimin e rezistencës. Në maj 2021, Plani Bazë i Qeverisë për Menaxhimin e Fatkeqësive u amendua për të rritur përqindjen e anëtarëve femra në këshillat lokale të menaxhimit të fatkeqësive dhe për të marrë masa parandaluese kundër abuzimit seksual dhe dhunës në familje gjatë fatkeqësive. Qeveria rriti gjithashtu numrin e grave anëtare të Këshillit Qendror të Menaxhimit të Fatkeqësive nga 11 në 33 për qind dhe numrin e grave eksperte në organin e saj ndihmës, Komitetin e Menaxhimit të Fatkeqësive, në 56 për qind. Drejtoresha e Përgjithshme e Byrosë për Barazinë Gjinore, znj. Tomoko Hayashi, është përfshirë në Shtabin e Qeverisë për Menaxhimin e Fatkeqësive dhe stafi i Byrosë për Barazi Gjinore është dërguar në ekipet e hetimit të Zyrës së Kryeministrit dhe në Shtabin e Menaxhimit të Fatkeqësive në vend. Në nivel lokal, gratë marrin pjesë në këshillat e menaxhimit të fatkeqësive dhe personeli femër caktohet në departamentet e menaxhimit të fatkeqësive.

Në **Serbi**, Ligji për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimin e Emergjencave (2018) thekson rëndësinë e aksesit të masave dhe aktiviteteve të DRR-së për personat me aftësi të kufizuara, dhe të drejtën për t'u informuar për risqet e fatkeqësive përmes informacionit të aksesueshëm të paraqitur në forma dhe formate lehtësisht të kuptueshme. Ligji ka prioritet evakuimin e personave me aftësi të kufizuara në raste emergjente dhe vendos protokolle për situata të ndryshme të reagimit emergjent për

personat me aftësi të kufizuara. Plani i Veprimit të Serbisë për zbatimin e Programit Kombëtar të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë (2017-2020) i referohet krijimit të "protokolleve për situata të ndryshme të reagimit emergjent për personat me aftësi të kufizuara - manuale në braj (alfabeti i shkrimit për të verbërit), aplikacione SMS-je dhe të ngjashme".

Në **Taxhikistan**, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për 2019–2030 merr parasysh qasjet e reja të Kornizës Sendai dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe synon zhvendosjen e fokusit nga menaxhimi i fatkeqësive në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, duke rritur rolin e gjinisë. Prioritet i jepet forcimit të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, rritjes së rezistencës së popullsisë dhe forcimit të infrastrukturës në kontekstin e integritetit të çështjeve të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në nivel lokal, zhvillimit dhe zbatimit të metodologjive dhe mjeteve të bazuara në shkencë për regjistrimin e humbjeve nga fatkeqësitë sipas gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar dhe informacioneve të tjera statistikore, dhe përmirësimi i modelimit, vlerësimit, hartës dhe monitorimit të riskut nga fatkeqësitë.

Jordania është kryesuese në rajonin arab për përfshirjen e gjinisë në politikat kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike. Plani i Reagimit të Jordanisë për Krizën e Sirisë 2021, i cili ofron një përgjigje gjithëpërfshirëse për të zbutur ndikimin që rezulton nga strehimi i refugjatëve sirianë, përfshin konsideratat gjinore me shënuesit e moshës, shënuesit e mbrojtjes sociale dhe mjedisin që monitorojnë cenueshmërinë e përfituesve dhe efikasitetin e ndërhyrjeve. Gjithashtu, Plani i dytë Kombëtar i Veprimit Jordanez (JONAP) mbi Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, aktualisht në fazën e hartimit, trajton sferën mjedisore, duke u fokusuar në rëndësinë e pjesëmarrjes së grave dhe personave me aftësi të kufizuara si në përshtatje ashtu edhe në përgjigjet zbutëse ndaj krizës së ndryshimeve klimatike.



ТАДЖИКИСТАН

©OECE

Përmirësoni planet e emergjencës dhe protokollet e paralajmërimit të hershëm:

Planifikimi i emergjencës dhe mjetet për vlerësime të shpejta të nevojave humanitare dhe emergjente duhet t'u përgjigjen nevojave gjinore dhe të përfshijnë aftësinë e kufizuar. Dizajni dhe planifikimi i sistemeve, protokolleve, procedurave standarde të funksionimit dhe infrastrukturës që përfshijnë aftësinë e kufizuar në përputhje me specifikimet teknike të disponueshme, për shembull, sigurimi i aksesit në njoftimet e paralajmërimit të hershëm nga persona të verbër ose me dëmtim të shikimit, do të bënte që të përfitonin jo vetëm personat me aftësi të kufizuara, por edhe të gjithë personat e tjerë me një vështirësi ose paaftësi për të lexuar materialin e shtypur ose personat që u mungojnë aftësitë shkrim-lexim (janë analfabetë). Protokollet e evakuimit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që personat me dëmtime kognitive të mund t'i ndjekin ato në rast urgjence. Duhet të futen shërbime të monitorimit dhe paralajmërimit të përgjigjshëm gjinor.

Rrisni lidërsipin e grave:

Krijoni një mjedis të përshtatshëm për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive dhe përfaqësimin në organet vendimmarrëse dhe të menaxhimit të krizave në nivele ndërkombëtare, rajonale, kombëtare dhe lokale përmes aktivitetëve të synuara për ngritjen e kapaciteteve. Rrisni lidërsipin e grave në të gjitha nivelet, duke njohur rolin e tyre si partnerë të barabartë në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë. Promovoni rolin e grave si reaguese të para dhe në përpjekjet për rikuperim, angazhimin e tyre aktiv në organizatat ose rrjetet e grave dhe grupet dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara. Identifikoni kampionët ose ndryshoni agjentët që mbështesin DRR-në gjithëpërfshirëse për mbrojtje dhe lobim.



PRAKTIKA TË MIRA Lidërsipin e grave

Znj. Nadejda Chetraru, shefe e Analizave të Drejtmeve, Planifikimit dhe Menaxhimit të Bazave të të Dhënave në Shërbimin e Mbrojtjes Civile dhe Situatave Emergjente në Ministrinë e Punëve të Brendshme të **Moldavisë**, drejtoi stërvitjen rajonale të DDR-së në terren EU MOLDEX 2017, të organizuar nga Programi i Financuar nga BE-ja për Parandalimin, Gatishmërinë dhe Reagimin ndaj Fatkeqësive Natyrore dhe të Atyre të Shkaktuara nga Njeriu në Vendet e Partneritetit Lindor (Programi Lindja 2 i PPRD-së). Ajo ishte gruaja e parë moldave që udhëhoqi një stërvitje në shkallë të plotë rajonale në terren të DRR-së. Stërvitja mbledhi 600 shpëtimtarë, ekspertë dhe vëzhgues nga gjashtë Vende Partnere Lindore (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina), si dhe nga Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në atë kohë, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Malta, Mali i Zi, Norvegjia, Rumania, Serbia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.



©Ms Colonel Ch. Ariunaa, NEMA, Mongolija

Kolonelja Chadraabal Ariunaa, shefe e Divizionit të Bashkëpunimit të Agjencisë Kombëtare të Menaxhimit të Emergjencave (NEMA) të **Mongolisë**, u zgjodh kryetare e Grupit të Punës Teknike të Statistikave të Fatkeqësive të Komisionit Ekonomik dhe Social për Azinë dhe Paqësorin (ESCAP) në 2020. Gjithashtu në vitin 2020, ajo u nderua me distinktivin 'Oficere' të Urdhrit Ndërkombëtar të Mbrojtjes Civile nga Organizata Ndërkombëtare e Mbrojtjes Civile, oficerja e parë e NEMA-s që iu dha ky titull nderi.

Kolonelja Ariunaa ka qenë e angazhuar në zvogëlimin dhe menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë për më shumë se 20 vjet, duke përfshirë përgatitjen e udhëzimeve arsimore për parandalimin e fatkeqësive dhe materialeve mësimore në kopshte dhe shkolla dhe ofrimin e trajnimeve për mësuesit.

Në **Tajlandë**, gratë janë një forcë shtytëse për DRR-në dhe përfshihen gjithnjë e më shumë profesionalisht në menaxhimin e fatkeqësive në nivel kombëtar. Znj. Pannapa (Aimee) Na Nan është drejtoreshë e Seksionit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Departamentin e Parandalimit dhe Zbutjes së Fatkeqësive (DDPM) në Ministrinë e Brendshme të Tajlandës. Ajo gjithashtu bashkëkryeson Grupin Teknik të Punës për Mbrojtjen, Gjininë dhe Përfshirjen, të mbledhur nga Shoqata e Komitetit të Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN) për Menaxhimin e Fatkeqësive. Politikat kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave zbatohen në Tajlandë përmes Planeve të Zhvillimit të Grave në përputhje me parimet e Kushtetutës së Mbretërisë së Tajlandës, CEDAW, Deklaratën e Pekinit dhe SDG-të.

Brenda tre javësh pas Tërmetit dhe Cunamit të Madh të Japonisë Lindore të marsit 2011, gratë japoneze në zonat e prekura dhe nga e gjithë **Japonia** u bashkuan për të formuar një koalicion ombrellë të grave të quajtur Rrjeti i Grave Japoneze për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (JWNDRR). Duke patur mbi 150 organizata japoneze të grave që iu bashkuan asaj, JWNDRR-ja përkrahu ndryshime legjislative dhe të politikës dhe zbatimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në përpjekjet e reagimit dhe rindërtimit. Rrjeti, i udhëhequr nga znj. Akiko Domoto, ish guvernatore e Prefekturës së Chiba-s, nxiti urgjentisht të bëheshin ndryshime sistematike në qeveritë kombëtare dhe lokale për të përfshirë një perspektivë gjinore si një aspekt themelor të politikës së fatkeqësive dhe rimëkëmbjes, dhe për të lejuar gratë nga zonat e prekura nga fatkeqësitë të marrin pjesë në politikëbërje. Përkrahja strategjike e JWNDRR-së ka rezultuar në reforma kyçe legjislative dhe të politikës për përfshirjen e perspektivave gjinore dhe të aftësisë së kufizuar, rritje të numrit të grave anëtare të emëruara në këshillat e menaxhimit të fatkeqësive në nivele lokale, prefekturë dhe kombëtare, dhe pjesëmarrje aktive të grave në politikëbërje dhe vendimmarrje, si dhe në zbatimin konkret të DRR-së në nivele lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Forconi mekanizmat rajonalë dhe kombëtarë për koordinim dhe partneritete:

Platformat rajonale dhe nën-rajonale dhe mekanizmat koordinues për DRR-në janë të dobishme për të sjellë së bashku qeveritë dhe palët e interesuara për të forcuar bashkëpunimin dhe partneritetet me qëllim që të trajtojnë rreziqet ndërkufitare, lehtësojnë shkëmbimin e përvojave, krijojnë rrjete, dhe të informohen për strategjitë kombëtare. Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar sjell së bashku organizatat e personave me aftësi të kufizuara nga e gjithë Evropa. Platforma të tjera rajonale janë Konferenca Ministrore e Azi-Paqësorit për DRR-në, Platforma Rajonale Arabe për DRR-në dhe Platforma Nën-Rajonale për DRR-në në Azinë Qendrore dhe Kaukazin e Jugut. Në nivel vendi, janë krijuar Platforma Kombëtare të cilat shërbejnë si një mekanizëm koordinues me shumë palë të interesuara për t'i dhënë prioritet fokusit ndaj gjinisë dhe personave me aftësi të kufizuara në DRR dhe për të lehtësuar planifikimin dhe zbatimin koherent.





PRAKTIKA TË MIRA Bashkëpunimi rajonal

Një shembull i mirë i bashkëpunimit rajonal për DRR-në që përfshin perspektivën gjinore është **Qendra për Situata Emergjente dhe Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë** që u krijua në Azinë Qendrore në vitin 2016. Qendra organizon takime të rregullta të krerëve të autoriteteve të urgjencës të vendeve të Azisë Qendrore, monitoron zbatimin e Kornizës Sendai në Azinë Qendrore dhe Kaukazin e Jugut dhe punon për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Një nga projektet me ndjeshmëri gjinore të zbatuar në Kazakistan, Kirgistan, Taxhikistan dhe Uzbekistan është projekti “Reduktimi i cenueshmërisë së popullatave në rajonin e Azisë Qendrore nga përmbytjet e shpërthimit të liqeneve të akullnajave në një klimë në ndryshim”. Projekti forcon kapacitetet monitoruese, analitike dhe të reagimit të institucioneve dhe zyrtarëve qeveritarë përgjegjës për DRR-në, urgjencat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përmes trajnimeve bazë me ndjeshmëri gjinore të komunitetit dhe fushatave të ndërgjegjësimit, si dhe përmes krijimit të sistemeve të paralajmërimit të hershëm. Nisma përfshin vlerësimin e cenueshmërisë dhe hartat e ekspozimit të hartuara për komunitetet e rrezikuara, duke përfshirë analiza specifike gjinore dhe sektoriale. Ai bashkëpunon me OJQ-të që trajtojnë çështjet e grave në të gjitha vendet pjesëmarrëse (p.sh., Forumi për OJQ-të e Grave në Kirgistan, i cili është themeluar dhe koordinator i Forumit të OJQ-ve të Grave të Azisë Qendrore).



Në nëntor 2021, **Forumit Evropian i Aftësisë së Kufizuar** publikoi për herë të parë një rishikim të politikave dhe praktikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë që përfshijnë aftësinë e kufizuar **në të gjithë Evropën**. Rishikimi do të mbështesë BE-në, qeveritë kombëtare dhe palët e tjera të interesuara në planifikimin, zbatimin dhe rishikimin e politikave të menaxhimit të fatkeqësisë dhe do të ndihmojë në udhëheqjen e organizatave të personave me aftësi të kufizuara teksa marrin pjesë në këtë proces. Për të informuar dhe drejtuar politikën e ardhshme, Forumi ka formuar katër burime në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë që përfshin aftësinë e kufizuar në 55 vende në Evropë dhe Azinë Qendrore.



TË INVESTOJMË NË ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA FATKEQËSITË

Ndajini fondet në buxhetet kombëtare:

Çrrënjësja e varfërisë dhe promovimi i qëndrueshmërisë janë synime të lidhura drejtpërdrejt me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. Qeveritë duhet të ndajnë një pjesë të mjaftueshme të buxhetit kombëtar për zvogëlimin gjithëpërfshirës të riskut nga fatkeqësitë nga të gjithë sektorët e në të gjitha nivelet, duke përafruar kornizat e integruara të financimit kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm ose planet kombëtare me strategjitë e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe duke miratuar një buxhetim që u përgjigjet çështjeve gjinore e që është i informuar për rrezikun, si edhe financim të bazuar në parashikime. Kjo duhet të përfshijë transferimin e burimeve financiare tek autoritetet provinciale dhe lokale për t'i fuqizuar ato dhe për të siguruar qasje dhe ndërhyrje të synuara dhe të fokusuara.



Zbatoni aktivitete me fokus gjininë dhe aftësinë e kufizuar:



Sigurohuni që qasjet që përfshijnë gjininë dhe aftësinë e kufizuar të jenë pjesë e planeve të veprimit të DRR-së, veçanërisht në zbatimin e aktiviteteve. Kjo përfshin promovimin dhe përfshirjen e DRR-së gjithëpërfshirëse në planet dhe projektet e zhvillimit dhe promovimin e koherencës përmes sistemeve, sektorëve dhe institucioneve që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe DRR-në.

Siguroni komunikim dhe arsimim të DRR-së me fokus gjininë dhe aftësinë e kufizuar:



Për të siguruar një përgjigje adekuate ndaj katastrofës, duhet që një sinjal alarmi me mesazhe të thjeshta që përmbajnë informacion të qartë të arrijë tek të gjithë. Mjetet e duhura të komunikimit në nivele kombëtare, rajonale dhe komuniteti duhet të identifikohen paraprakisht. Përdorimi i disa kanaleve të komunikimit është i nevojshëm për të siguruar që të gjithë janë paralajmëruar, për të përforcuar mesazhet paralajmëruese dhe për të kompensuar dështimin e mundshëm të një kanali të vetëm. Për të kundërshtuar stereotipet negative të personave me aftësi të kufizuara, është e nevojshme të rriten njohuritë, aftësitë dhe ndërgjegjësimi në lidhje me aftësinë e kufizuar. Programet dhe kurrikulat për DRR-në gjithëpërfshirëse duhet të futen në të gjitha nivelet arsimore në bashkëpunim me ministrinë e arsimit.



PRAKTIKA TË MIRA DRR-ja gjithëpërfshirëse në arsim

Në **Armeni**, përgatitja e stafit të shkollës dhe nxënësve me dhe pa nevoja të veçanta për fatkeqësitë u përmirësua në një program të financuar nga Programi i Gatishmërisë për Fatkeqësitë i Departamentit të Ndhmës Humanitare të Komisionit Evropian (DIPECHO) dhe u realizua në partneritet me UNICEF-in, UNDP-in, Save the Children (Shpëto fëmijët), Oxfam dhe Shoqërinë e Kryqit të Kuq Armen (ARCS). Programi përfshinte shkollimin për DRR-në, ngritjen e kapaciteteve, rritjen e gatishmërisë teknike të institucioneve për situata emergjente dhe evakuimin, si dhe mbështetjen për përfshirjen e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në strategjinë kombëtare të DRR-së. Në qendrat e kujdesit ditor për fëmijët me nevoja të veçanta, programi prezantoi një emision të përmirësuar të paralajmërimit për personat me aftësi të kufizuara në shikim ose dëgjim, paraqitje grafike gjithëpërfshirëse të sigurisë nga zjarri dhe ashensorë gjithëpërfshirës për ata me karrige me rrota. Politika e Armenisë mbi DRR-në udhëhiqet nga Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani i saj i Veprimit dhe ka zhvilluar mjete gjithëpërfshirëse, duke përfshirë vlerësimin e Menaxhimit të Riskut në Nivel Lokal (LLRM) duke marrë parasysh njerëzit me nevoja të veçanta.



Në **Algjeri**, Universiteti i Chlef-it udhëhoqi një iniciativë që inkurajonte gratë algeriane për të ndjekur programe master dhe doktoraturë në fushën e inxhinierisë që lidhet me reduktimin e risqeve të tërmeteve dhe klimës. Universiteti u përpoq të siguronte një ekuilibër gjinor në programet e tij akademike të lidhura me DRR-në, që rezultoi në një numër të madh grash të diplomuara e shumë të trajnuara në këtë fushë. Nisma kontribuoi në rritjen e angazhimit të grave në projekte kërkimore publike dhe industriale dhe kontributit të tyre për ndërtimin e kapaciteteve të komuniteteve të tyre lokale për të identifikuar e zbutur fatkeqësitë dhe për t'iu përgjigjur atyre në mënyrë efektive.

Forconi kapacitetin dhe rolin e medias:



Pjesëmarrja e komunitetit është e rëndësishme për zgjerimin e ndërhyrjeve të ndjeshme ndaj gjinisë dhe aftësisë së kufizuar në të gjitha fazat e DRR-së, duke përfshirë paralajmërimin e hershëm, reagimin, rimëkëmbjen. Është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi i publikut për risqet nga fatkeqësive dhe të krijohet një infrastrukturë komunikimi efektive. Duhet të krijohen mekanizma për një bashkëpunim më të mirë midis qeverive, organizatave të medias kombëtare dhe palëve të interesuara që merren me informacionin thelbësor për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, si edhe për të siguruar që të ofrohet informacion se si komunitetet mund të reduktojnë riskun dhe ku dhe si mund të kërkojnë ndihmë në rast të një fatkeqësie apo krize.

Investoni në ekspertizë që u përgjigjet nevojave gjinore dhe përfshin aftësinë e kufizuar:



Politikat e DRR-së dhe menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë mund të përmirësohen duke krijuar një grup ekspertësh në nivele kombëtare dhe rajonale dhe duke ngritur pika/pozicione qendrore gjinore për DRR-në në institucionet kombëtare dhe njësitë e administratës rajonale. Kapacitetet duhet të ndërtohen gjithashtu brenda ekipeve dhe menaxhmentit ekzistues të DRR-së për të siguruar reagim ndaj çështjeve gjinore dhe përfshirje të aftësisë së kufizuar nga ana e reaguesve të vijës së parë ose reaguesve të parë në situata shpërthyes të një kërkese të papritur ose më të zgjatur.

Investoni në inovacion dhe njohuri:



Shkenca dhe teknologjia mund të përdoren për të forcuar DRR-në për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar të kuptuarit që ka shoqëria për riskun nga fatkeqësitë. Planet dhe hartat e evakuimit për studentët me shikim të dëmtuar ose videot që shfaqin sjellje të rekomanduara gjatë valëve të të nxehtit ose rreziqeve të tjera për studentët me dëmtim të dëgjimit janë shembuj të mirë të inovacioneve. Teknologji të tilla si gjurmimi i telefonave celularë ose platformat satelitore dhe baza e të dhënave mund të përdoren për të mbështetur DRR-në gjithëpërfshirëse.

Stimuloni angazhimin e donatorëve për aktivitetet dhe investimet gjithëpërfshirëse të DRR-së:



Donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare inkurajohen të integrojnë DRR-në gjithëpërfshirëse në asistencën e tyre për zhvillim, me mekanizma të dedikuar për vendet e cenueshme dhe ato të ekspozuara në vështirësi borxhi. Ndërkohë që tashmë janë krijuar disa platforma dhe partneritete thelbësore (Kompakti Global i OKB-së, Iniciativa e Biznesit Lidhës të UNDP-së, Rrjetet ARISE të UNDRR-së - Aleanca e Sektorit Privat për Shoqëritë Rezistente ndaj Fatkeqësive), dhe CSR-ja e korporatave dhe iniciativat filantropike socio-ekonomike [p.sh. Të Krijojmë Qytete të Zgjuara (Inteligjente)], projektet dhe investimet duhet të fokusohen më shumë në zgjidhje të qëndrueshme për të siguruar ndikim afatgjatë, p.sh., plotësimi i financimit të DRR-së, ose asistencë/mbështetje teknike për zhvillimin e politikave dhe planeve kombëtare dhe nën-kombëtare të DRR-së. Partneritetet publiko-private janë thelbësore në shkallëzimin e inovacioneve, si dhe angazhimin e ndërmarrjeve të mesme, të vogla dhe mikro në DRR për ndërtimin e ekonomive dhe komuniteteve rezistente.



TË RRISIM GATISHMËRINË NDAJ FATKEQËSIVE DHE TË RINDËRTOJMË MË MIRË

Të rrisim qëndrueshmërinë e përgjithshme të komuniteteve:

Mbështetni qëndrueshmërinë (rezistencën) dhe qasjen ndaj burimeve të grave dhe vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara duke mbështetur risitë në DRR dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, të tilla si sobat me lëndë djegëse, grumbullimi i druve të zjarrit, ruajtjen e ushqimit të thatë, ruajtjen e ujit, blerjen e mallrave thelbësore, dhe ndërtimin e rrjeteve sociale brenda komuniteteve. Është e rëndësishme që ndërhyrjet të hartohen duke marrë parasysh pabarazitë dhe dallimet midis grave dhe burrave.



PRAKTIKA TË MIRA

Rritja e qëndrueshmërisë së komunitetit

Një projekt në **Egjiptin** e **Epërm** rriti qëndrueshmërinë e grave që jetojnë në fshatra për të kundërshtuar rrezikun e humbjes së mjeteve të jetesës me të cilat mund të përballen në një fatkeqësi. Projekti, i cili synonte rreth 250 gra, rriti të kuptuarit e tyre për risqet nga fatkeqësitë, ofroi trajnime për mjetet alternative të sigurimit të jetesës dhe mjetet teknike për zbatimin e tyre, si makinat e qepjes dhe thurjes, tezgjahut për qilim dhe bagëtitë. Gratë e synuara ishin të përfshira në mënyrë aktive që në fillim: ato ishin të lidhura me organizatat e komunitetit lokal dhe shoqatat e grave në bazë dhe patën mundësinë të shprehnin ndikimet e riskut me të cilat u përballen dhe të bënin sugjerime për zgjidhje.

Në **Gjeorgji**, u prezantua një skemë e inovacioneve komunitare me kosto të ulët për të krijuar qëndrueshmërinë e përgjithshme të grave

(risitë që lidhen me përpunimin e ushqimit dhe gjenerimin e të ardhurave) dhe burrave (risitë që lidhen me burimet alternative të energjisë) për të krijuar qëndrueshmërinë e tyre të përgjithshme ndaj goditjeve dhe fatkeqësive të mundshme në komunitet.

Në **Tunizinë** veriperëndimore, një iniciativë që përfshin Shoqatën Khir dhe Khemir, Ambasadën Gjermane në Tunizi dhe institucionet publike lokale synonte të zvogëlonte ndikimin e pandemisë COVID-19 dhe të krijonte rezistencë duke mobilizuar aftësitë dhe ekspertizën e grave për të forcuar higjenën lokale. Aktivitetet u fokusuan në prodhimin e artikujve që nevojiten urgjentisht në vijën e parë dhe në ndërmarrjen e testimit dhe fushatave ndërgjegjëse për COVID-19. Projekti angazhoi gratë rurale në zvogëlimin e risqeve shëndetësore që lidhen me përhapjen e COVID-19, ndërtoi kapacitetin e grave oficerë mjekësore dhe punonjësve të tjerë të vijës së parë për përgjigjen ndaj COVID-19, angazhoi gra specialiste në projektimin dhe prodhimin e maskave mbrojtëse në 'Fab Labs' të themeluara në vend, kuroi përvojën, aftësitë dhe shpejtësinë e rrobaqepëseve që operojnë në rajonin e synuar në prodhimin e kominosheve, grykëseve për fëmijë që mund të lahen, mbulesave të krevatit të papërshkueshme nga uji sipas standardeve të industrisë dhe siguroi pjesëmarrjen e grave në një grup pune për zhvillimin, zbatimin, dhe monitorimin e një plani veprimi të komunikimit efektiv dhe që i përgjigjet nevojave gjinore për COVID-19.



GEORGIA

©Oxfam GB Georgia/Bridge

Forconi kapacitetet e grave dhe personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e DRR-së:



Të mbështesim gratë dhe vajzat dhe personat me aftësi të kufizuara si avokate dhe agjente të ndryshimit dhe pjesëmarrjes në planifikimin e fatkeqësive dhe të gjitha fazat e DRR-së dhe zhvillimit afatgjatë. Përfshini personat lokalë me aftësi të kufizuara dhe organizatat e grave që kanë njohuri për nevojat dhe kapacitetet specifike të grave dhe burrave, si dhe ato me nevoja të veçanta në zona të largëta. Mbështesni pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara si përfaqësues të përdoruesve të shërbimeve në qeverisjen e ofruesve të shërbimeve. Siguroni përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në vendosjen e standardeve minimale për ndihmë lehtësuese gjithëpërfshirëse për aftësinë e kufizuar. Trajtoni punonjësit e ndihmës lehtësuese për punën e ndihmës lehtësuese që përfshin aftësinë e kufizuar. Përfshini auditimet e aftësisë së kufizuar në vlerësime. Identifikoni kampionët lokalë për të mbështetur DRR-në që përfshin aftësinë e kufizuar në nivel komuniteti.

Përmirësoni infrastrukturën strukturore dhe jo-strukturore



DRR-ja duhet të fokusohet më shumë në zgjidhje të qëndrueshme me ndikim afatgjatë si forcimi institucional, ndërtimi i kapaciteteve, paralajmërimi dhe parandalimi i hershëm, gatishmëria, komunikimi i riskut nga fatkeqësitë, si dhe infrastruktura të qëndrueshme ndaj klimës dhe infrastruktura dhe sistemet sociale me në qendër njerëzit. Partneritetet publiko-private janë thelbësore në shkallëzimin e inovacioneve, si dhe në angazhimin e ndërmarrjeve të mesme, të vogla dhe mikro në DRR për ndërtimin e ekonomive dhe komuniteteve të qëndrueshme.

Siguroni pjesëmarrjen e grave dhe personave me aftësi të kufizuara në rimëkëmbje, rindërtim dhe rehabilitim:



Strukturoni burimet dhe angazhoni gratë dhe personat me aftësi të kufizuara në rimëkëmbjen afatgjatë. Projektoni ndërhyrje që marrin në konsideratë pabarazitë dhe dallimet midis grave dhe burrave. Një dritare mundësisht është e disponueshme përmes masave të rimëkëmbjes dhe rindërtimit pas fatkeqësisë për të investuar në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë që përfshijnë aftësinë e kufizuar, duke ndarë më shumë burime nën ombrellën e përgjithshme të sektorit social, si për arsimin, shëndetin dhe mbrojtjen sociale.



PRAKTIKA TË MIRA

Ndërtimi i kapaciteteve të DDR-së për gratë dhe personat me aftësi të kufizuara

Në **Armeni**, Ministria e Situatave të Emergjencave dhe Platforma Kombëtare DRR hartuan programin Ta Shndërrojme Cenueshmërinë në Partneritet, duke ofruar punësim për personat me aftësi të kufizuara në Ministri dhe Qendrën e Menaxhimit të Krizave dhe Shërbimin e Reagimit të Shpejtë 911. Aktualisht janë 35 persona me aftësi të kufizuara të punësuar në shërbimin 911. Për më tepër, Akademia Shtetërore e Menaxhimit të Krizave e ministrisë, e cila trajnon burra dhe gra çdo vit, futi përfshirjen gjinore dhe aftësinë e kufizuar si pjesë të kursit për gatishmërinë dhe reagimin ndaj fatkeqësive.


Në **Ukrainë**, Koordinator i Projektit të OSBE-së në Ukrainë ofroi trajnime të trajnerëve mbi reagimin e urgjencës kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN) për praktikuesit femra dhe meshkuj, duke siguruar pjesëmarrjen e përfaqësueseve femra. Detyrat kryesore të grupit përfshinin kryerjen e punimeve për mbrojtjen nga rrezatimi si dhe ai kimik dhe biologjik; kryerjen e operacioneve të shpëtimit në zona të rrezikshme dhe të kontaminuara; reagimin ndaj incidenteve CBRN në prani të kërcënimeve dytësore si temperaturat ekstreme, ndotja e gazit, rrëshqitjet e dheut, përmytjet, rrezatimi dhe kontaminimi bakterial dhe lokalizimi i zonave të ndikimit të faktorëve të dëmshëm dhe të rrezikshëm që ndodhin gjatë aksidenteve, katastrofave, zjarreve dhe fatkeqësive natyrore.



Gjeorgjia promovon lidhësinë e grave në nivel rajonal dhe komunitar, për shembull përmes programit të Komisionit Evropian të financuar nga DIPECHO për angazhimin e grave për të udhëhequr në grupet vullnetare të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në komunitet, proceset e vlerësimit të cenueshmërisë së komunitetit dhe në arsimimin përmes promovimit të grave si eksperte në shkollimin për DRR-në.

SHTOJCAT

BURIMET / PAKETAT E MJETEVE / MANUALET




[Vlerësimi Rajonal për Implikimet e Sigurisë të Evropës Juglindore për Ndryshimet Klimatike](#)

I hartuar në vitin 2021 nga OSBE-ja në partneritet me Adelphi, botimi fokusohet në analizën gjinore të sigurisë klimatike në rajonin e OSBE-së. Ai nënvizon dallimet gjinore si faktorë përcaktues të cenueshmërisë klimatike, si thatësira e shkaktuar nga migrimi klimatik i grave dhe familjeve ose mungesa e kontrollit mbi asetet ekonomike që nuk janë në gjendje të përballen me risqe klimatike.




[Udhëzues Familjar për Gatishmërinë dhe Reagimin ndaj Emergjencave](#)

Ky udhëzues u hartua nga Misioni i OSBE-së në Serbi së bashku me Ministrinë e Brendshme të Serbisë. Qëllimi i udhëzuesit është të udhëzojë familjet, gratë, burrat, djemtë dhe vajzat se si të reagojnë më mirë ndaj një aksidenti. Ai paralajmëron për rreziqet, por gjithashtu ofron përgjigje dhe sugjerime që mund të jenë të vlefshme në kohë fatkeqësie. Disa elementë të Udhëzuesit Familjar u përfshinë në Manualin mbi Bazat e Sigurisë së Fëmijëve, që ishte i ilustruar dhe u shpërnda në të gjithë vendin.




[Integrimi Gjinor në Qeverisjen në Sektorin e Ujit në Azinë Qendrore](#)

Ky botim u hartua nga Zyra e Koordinatorit të Aktiviteteve Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së për të mirën e praktikuesve të ujit në rajon. Integrimi gjinor në qeverisjen në sektorin e ujit kontribuon në stabilitetin dhe sigurinë pasi mund të çojë në politika më efektive dhe mund të punojë për të reduktuar pabarazitë sociale dhe tensionin. Kur gratë dhe burrat vendosin në mënyrë të barabartë se si të përdorin ujin, vendimet janë më të synuara dhe më përfaqësuese të nevojave të të gjithë popullsisë.




[Integrimi Gjinor në Aktivitetet e Qendrave Aarhus: Udhëzime për Praktikuesit](#)

Sekretariati i OSBE-së botoi këto udhëzime për të ndihmuar stafin e Qendrës Aarhus dhe palët e interesuara të Aarhus-it për të integruar në mënyrë efektive një perspektivë gjinore në punën e tyre dhe për të realizuar angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore. Ata sugjerojnë pika hyrëse konkrete dhe praktike për integrimin e perspektivës gjinore në aktivitetet që lidhen me të tre shtyllat e Konventës së Aarhus-it (qasja ndaj informacionit, pjesëmarrja e publikut dhe aksesimi në drejtësi), si dhe në mbështetje të parimeve të OSBE-së për barazinë gjinore.




[Media, Gjinia dhe Raportimi i Emergjencave](#)

Kjo është një broshurë për gazetarët dhe profesionistët që merren me raportimin për përmblytjet dhe është hartuar nga Misioni i OSBE-së në Serbi. Duke theksuar rolin e rëndësishëm të medias në rritjen e qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj emergjencave, ajo fokusohet në ndjeshmërinë gjinore në raportimin e fatkeqësive natyrore dhe situatave emergjente. Temat e mbuluara përfshijnë detyrimet etike dhe ligjore, raportimin e gabuar dhe perspektivën gjinore në raportim, duke përfshirë rolin e grave dhe rekomandimet për intervistimin e viktimave të fatkeqësive. Si rast studimi, broshura përshkruan raportimin e mediave gjatë dhe pas përmblytjeve në Serbi në vitin 2014, i karakterizuar jo vetëm nga portretizimet stereotipe gjinore të burrave dhe grave, por edhe nga dukshmëria shumë e kufizuar e kontributit të grave në reagimin humanitar.




[Përtej Cenueshmërisë ndaj Barazisë Gjinore dhe Fuqizimit dhe Lidërshipt të Grave në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë: Veprimet Kritike për Sistemin e Kombeve të Bashkuara](#)

Ky Studim i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara mbi Statusin e Barazisë Gjinore dhe Lidërshiptin e Grave në DRR shtron pyetjen se si sistemi i Kombeve të Bashkuara dhe çdo entitet individual mund të mbështesë më mirë Shtetet Anëtare për të fuqizuar gratë dhe për të promovuar lidërshiptin e grave në qeverisjen e fatkeqësive dhe riskut klimatik për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të informuar për rreziqet që nuk lë askënd pas. Ai eksploron se çfarë duhet të ndryshojë në qasjen e sistemit të Kombeve të Bashkuara në tërësi për të bërë përparim praktik të rëndësishëm në barazinë gjinore në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë deri në vitin 2030.



[Shënim Udhëzues Për Vendosjen e Qasjeve të Përgjigjshme Gjinore Përkundrejt Reagimit dhe Rimëkëmbjes ndaj COVID-19](#)

Ajencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar e përgatiti këtë botim si pjesë të angazhimit të saj për të forcuar iniciativat e saj të përgjigjshme gjinore dhe për të siguruar që askush të mos mbetet pas. Ai ofron njohuri mbi sfidat dhe risqet me të cilat përballen gratë dhe vajzat në lidhje me pandeminë COVID-19 dhe rekomandon veprime praktike specifike kur planifikohen dhe ndërmerren programe për përgjigje dhe rimëkëmbje. Ai nënvizon katër fusha prioritare të veprimit: (i) promovon pjesëmarrjen e barabartë të grave në vendimmarrje dhe forcon fuqizimin e tyre ekonomik; (ii) garanton sigurinë e punonjëseve femra të kujdesit shëndetësor dhe adreson shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese; (iii) eliminon dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore; dhe (iv) siguron mundësi të qëndrueshme dhe të barabarta arsimore.



[Tërmeti i Madh i Japonisë Lindore – Mësimi nga Mega Fatkeqësitë: Shënime Njohurish, Përmbledhje Ekzekutive](#) është një rezultat i projektit të Qeverisë së Japonisë dhe Grupit të Bankës Botërore për mega fatkeqësitë. Ai përmban informacion mbi sukseset e sistemit të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë e Japonisë dhe mënyrat me të cilat sistemi mund të përmirësohet, të nxjerra nga mësimet e marra nga Tërmeti i Madh i Japonisë Lindore i vitit 2011. Ai synon të ndajë njohuritë e Japonisë mbi menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe rindërtimin pas fatkeqësive me vendet e cenueshme ndaj fatkeqësive, si dhe të inkurajojë vendet që të përfshijnë menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në politikat dhe planifikimin e tyre të zhvillimit.




[Korniza dhe Mjetet për Matjen e Lidërshiptit dhe Pjesëmarrjes Kuptimplotë të Grave në Përgjigjet ndaj COVID-19](#)

Zyra Rajonale e Grave të Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Paqësorin dhe Grupi Këshillues Humanitar përgatitën këtë botim në mars të vitit 2021 me mbështetje fondesh nga Qeveria e Japonisë. Ai ofron mjete për gjurmimin e progresit dhe ndikimin e udhëheqjes së grave, organizatave për të drejtat e grave dhe organizatave të fokusuara tek gratë dhe pjesëmarrjen e tyre kuptimplotë në përgjigjet ndaj COVID-19 në Azi dhe Paqësor. Mjetet, të cilat përfshijnë një kornizë matjeje, një mjet anketimi të vetëvlerësimit dhe udhëzuesit kryesorë të intervistave të informatorëve mund të përdoren si në sektor apo vend ashtu edhe në nivel organizativ dhe mund të përshtaten për të matur udhëheqjen në kriza dhe fatkeqësi të tjera.



[Dimensionet Gjinore të Riskut dhe Qëndrueshmërisë ndaj Fatkeqësive – Dëshmi Ekzistuese](#)

Ky raport, i hartuar nga Banka Botërore dhe Fondi Global për Reduktimin e Fatkeqësive Natyrore dhe Rimëkëmbjen, përmban kontribute të jashtme që ofrojnë dëshmi mbi boshllëqet gjinore në rezultatet e fatkeqësive dhe qëndrueshmërinë dhe nxitësit themelorë të këtyre boshllëqeve, duke përfshirë boshllëqet më të rëndësishme të njohurive dhe të dhënave. Ai tregon se si ndikimi i fatkeqësive shpesh reflekton dhe përforcon pabarazinë gjinore. Raporti ofron gjithashtu një kornizë të dobishme operacionale që mund të përdoret për vlerësimet lokale të dinamikës gjinore në riskun ndaj fatkeqësive si edhe qëndrueshmërinë.




[Rezultatet Paraprake nga një Vlerësim i Shpejtë Gjinor mbi Ndikimin e COVID-19 në Jetën dhe Mjetet e Jetesës së Grave dhe Burrave në Evropë dhe Azinë Qendrore](#)

Anketa e shpejtë e vlerësimit gjinor u krye nga Zyra Rajonale e Grave të Kombeve të Bashkuara për Evropën dhe Azinë Qendrore, përmes programit global Të Bëjmë që çdo Grua dhe Vajzë të Llogaritet. I zhvilluar midis prillit dhe qershorit të vitit 2020, ai bazohet në të dhënat e vlerësimit të shpejtë gjinor të mbledhura në Ballkanin Perëndimor, Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, duke përfshirë Shqipërinë, Azerbajxhanin, Bosnjen dhe Hercegovinën, Gjeorgjinë, Kazakistanin, Kirgistanin, Moldavinë, Maqedoninë e Veriut dhe Turqinë. Të dhënat e anketës vlerësojnë gjithashtu rritjet e perceptuara të diskriminimit dhe dhunës në familje bazuar në përvojat personale të të anketuarve dhe të kuptuarit e sigurisë.




[Reduktimi i Riskut nga Gjinitë dhe Fatkeqësitë në Evropë dhe në Azinë Qendrore: Udhëzues i Uorkshopit për Ndërmjetësuesit](#)

Udhëzuesi u hartua nga Zyra Rajonale e Grave të Kombeve të Bashkuara për Evropën dhe Azinë Qendrore dhe Qendra Rajonale e UNDP-së në Stamboll për Evropën dhe CIS për praktikuesit dhe zyrtarët e Kombeve të Bashkuara, qeverive kombëtare, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera për t'i ndihmuar ata të forcojnë të kuptuarit e tyre për ndikimin gjinor të fatkeqësive. Gjithashtu ky udhëzues i ndihmon ata të planifikojnë, zbatojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë programet dhe iniciativat e DRR-së që u përgjigjen çështjeve gjinore.



[Rishikimi i Politikës dhe Praktikave për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësive që Përfshijnë Aftësinë e Kufizuar në Evropë dhe Azinë Qendrore](#)

Ky rishikim ishte i pari që u publikua nga Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar (EDF) në nëntor të vitit 2021 për të mbështetur BE-në, qeveritë kombëtare dhe palët e tjera të interesuara në planifikimin, zbatimin, dhe rishikimin e politikave të menaxhimit të fatkeqësive, dhe për të udhëhequr organizatat e personave me aftësi të kufizuara për sa kohë ata marrin pjesë në këtë proces. Për të informuar dhe drejtuar politikën e ardhshme, EDF-ja ka krijuar katër burime në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe që përfshijn aftësinë e kufizuar në 55 vende në Evropë dhe Azinë Qendrore.




[Udhëzuesi dhe Paketa e Mjeteve \(Toolkit\) për Burimet Ndërsektoriale: Një Qasje Ndërsektoriale për të Mos Lënë Askënd Pas](#)

Ky udhëzues burimesh dhe Paketa e Mjeteve (Toolkit) synojnë të ndihmojnë si organizatat ashtu edhe praktikuesit dhe ekspertët individualë për të trajtuar ndërsektorialitetin në politika dhe programe. Është rezultat i një përpjekjeje bashkëpunuese midis Grave të Kombeve të Bashkuara, Partneritetit të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNPRPD), Anëtarëve të Grupit Këshillues të Shoqërisë Civile duke përfshirë Aleancën Ndërkombëtare për Aftësinë e Kufizuar dhe anëtarët e Komunitetit të saj të Praktikës, si dhe partnerët e projekteve të përbashkëta midis agjensive.



Kuadri Legjislativ Gjithëpërfshirës Gjinor dhe Ligjet për të Forcuar Rezistencën e Grave ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Fatkeqësive

Botuar nga Banka Aziatike për Zhvillim (ADB) në dhjetor të vitit 2021, ky raport ofron një kuadër konceptual dhe udhëzues të praktikave të mira se si të integrohet barazia gjinore në ligje dhe politika mbi ndryshimet klimatike dhe menaxhim të fatkeqësive në vendet anëtare në zhvillim të ADB-së. Ai demonstroi gjithashtu se si ligjet dhe politikat e përgjigjshme ndaj gjinisë mund të kontribuojnë në rezistencën e grave ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive. Raporti u hartua për t'u përdorur nga qeveritë, politikëbërësit, organizatat dhe individët e angazhuar në reformat legjislative që u përgjigjen çështjeve gjinore.



Plani i Veprimit të Buxhetimit që i Përgjigjet Çështjeve Gjinore për Tajlandën

Plani i Veprimit ofron një udhërrëfyes për zbatimin e një qasjeje në rritje ndaj buxhetimit që i përgjigjet çështjeve gjinore për një afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë. Ishte një iniciativë e përbashkët e Qeverisë së Mbretërisë së Tajlandës dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, në veçanti Byrosë Buxhetore dhe Departamentit për Çështjet e Grave dhe Zhvillimin e Familjes dhe demonstroi përkushtimin e Tajlandës për të adresuar pabarazitë gjinore përmes buxhetimit që i përgjigjet çështjeve gjinore në faza të ndryshme të ciklit buxhetor. Koncepti u përfshi edhe në Kushtetutën e vitit 2017.



Bërja e Zvogëlimit të Riskut nga Katastrofat të Ndjeshëm ndaj Gjinisë: Politika dhe Udhëzime Praktike

Këto udhëzime ofrojnë politika dhe udhëzime praktike për qeveritë kombëtare dhe vendore për të zbatuar më tej Kornizën Hyogo për Veprim, e cila ishte politika dhe udhëzimet praktike për qeveritë kombëtare dhe vendore për të zbatuar më tej Kornizën Hyogo për Veprim ndërmjet viteve 2005 dhe 2015. Botuar nga UNISDR, UNDP dhe IUCN në vitin 2009, korniza ishte rezultat i konsultimeve të gjera dhe një përgjigje ndaj thirrjes për politika të qarta dhe udhëzime praktike për integrimin e perspektivave gjinore në reduktimin e riskut nga fatkeqësitë.



KORNIZAT DHE POLITIKAT

GLOBALE

- Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (2015-2030)
- Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të saj
- Neni 7 (5) i Marrëveshjes së Parisit
- Axhenda e Re Urbane
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)
- Agjenda e Veprimit Addis Abeba për Financimin e Zhvillimit
- Samiti Botëror Humanitar 2016
- Axhenda për Njerëzimin
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Rekomandimi i përgjithshëm nr. 37 (2018) mbi dimensionet e lidhura me gjininë të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në kontekstin e ndryshimeve klimatike
- Rezoluta S/RES/1325 and dhe Rrjeti Ndërinstitucional i Këshillit të Sigurimit për Gratë dhe Barazinë Gjinore
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj Fakultativ
- Strategjia e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen e Aftësisë së Kufizuar
- Plani Global i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë 2014-2021
- Konventa e Aarhus-it
- Plani i Veprimit për Përfshirjen e Aftësisë së Kufizuar 2018-2023 i Institucionit Global për Reduktimin dhe Rimëkëmbjen nga Fatkeqësitë (GFDRR)

RAJONALE

- **Bashkimi Evropian**
 - Angazhimet e BE-së ndaj SDG-ve
 - Plani i Veprimit Gjiner III i BE-së 2021–2025
 - Strategjia Evropiane e Aftësisë së Kufizuar 2021–2030
 - Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së 2001; Plani i Veprimit i Komisionit Evropian për Kornizën Sendai për DRR-në 2015–2030
 - Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020–2025
 - Strategjia e BE-së për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2021
 - Kuadri i BE-së për Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- **Europa**
 - Udhërrëfyesi i Forumit Evropian për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (EFDRR) 2021–2030
- **Azia Qendrore dhe Kaukazi i Jugut**
 - Strategjia për Zhvillimin e Bashkëpunimit ndërmjet Vendeve të Azisë Qendrore në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për 2022–2030
 - Plani i Veprimit për Zbatimin e Kornizës Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për 2015–2039 në rajonin e Azisë Qendrore dhe Kaukazit Jugor
 - Deklarata e Dushanbe-s 2016 për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për Ndërtimin e Rezistencës
 - Deklarata e Jerevan-it 2018

Azia-Paqësori

- Plani i Veprimit Azi-Paqësor 2021–2024 për zbatimin e Kornizës Sendai për DRR-në
- Plani i Veprimit 2018–2020 i Planit Rajonal të Azisë për Zbatimin e Kornizës Sendai për DRR-në 2015–2030
- Deklarata e Ulaanbaatar-it 2018
- Rekomandimet e Hanoi-it 2016 për Veprim mbi Gjirinë dhe DRR-në
- Marrëveshja ASEAN për Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Reagimet Emergjente (AADMER)
- Strategjia e Incheon-it “Bëje të Duhurën të Vërtetë” për Personat me Aftësi të Kufizuara: Deklarata Ministrore e OKB-së ESCAP mbi Dekadën Aziatike dhe Paqësore të Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2022

Shtetet Arabe


- Strategjia Arabe për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2030
- Plani Prioritar i Veprimit 2018-2020 i Strategjisë Arabe për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2030
- Plani i Veprimit me Prioritet për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2021–2024
- Deklarata e Veprimit Vullnetar (VAS) e Grupit Vullnetar të Palëve të Interesit për Barazinë Gjimore dhe Fuqizimin e Grave për DRR-në, Ndryshimet Klimatike dhe Migracionin (Shtetet Arabe) në Platformën e Pestë Rajonale Arabe për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë

PLATFORMAT RAJONALE²

Platformat rajonale janë forume me shumë palë të interesuara që pasqyrojnë angazhimin e qeverive për të përmirësuar koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve të DRR-së duke u lidhur ato me përpjekjet ndërkombëtare dhe kombëtare. Të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e Kornizës Sendai, ato shërbejnë për të diskutuar çështjet ndërkufitare rreth parandalimit dhe gatishmërisë ndaj fatkeqësive, për të ofruar udhëheqje dhe drejtime dhe për të propozuar zgjidhje përkatëse për të trajtuar problemin e riskut të fatkeqësive dhe

për të ndërtuar qëndrueshmërinë e komuniteteve dhe kombeve.

Zyrat rajonale të Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (UNDRR) shërbejnë si sekretariat mbështetës për këto platforma rajonale. Figura 2 më poshtë tregon platformat përkatëse rajonale në të cilat kanë marrë pjesë Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe Partnerët për Bashkëpunim të mbuluara nga ky studim.



PLATFORMAT RAJONALE





Figura 2: Platformat rajonale ku morën pjesë Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe Partnerët për Bashkëpunim

² Faqja e internetit e UNDRR-së: <https://www.undrr.org/implementing-sendai-framework/regional-platforms>



Rindërto më Mirë

Përdorimi i fazave të rimëkëmbjes, rehabilitimit dhe rindërtimit pas një fatkeqësie për të rritur qëndrueshmërinë e kombeve dhe komuniteteve përmes integritit të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në restaurimin e infrastrukturës fizike dhe sistemeve shoqërore dhe në rigjallërimin e mjeteve të jetesës, ekonomive dhe mjedisit [Përkufizimi i UNDRR-së].



Kapaciteti

Kombinimi i të gjitha fuqive,tributeve, dhe burimeve të disponueshme brenda një komuniteti ose shoqërie për të menaxhuar dhe zvogëluar risqet nga fatkeqësitë dhe për të forcuar qëndrueshmërinë.

Shënim: Kapaciteti mund të përfshijë infrastrukturën, institucionet, njohuritë dhe aftësitë njerëzore dhe atributet kolektive të tilla si marrëdhëniet shoqërore, udhëheqja, dhe menaxhimi [Përkufizimi i UNDRR-së].



Përshtatja Klimatike / Zbutja e Klimës

Përshtatja klimatike i referohet rregullimeve në sistemet ekologjike, sociale ose ekonomike në përgjigje të stimujve aktualë ose të pritshëm klimatik dhe efekteve ose ndikimeve të tyre. Ajo i referohet ndryshimeve në procese, praktika, dhe struktura për të zbutur dëmet e mundshme ose për të përfituar nga mundësitë që lidhen me ndryshimet klimatike [Përkufizimi i UNFCCC-së].

Zbutja e klimës i referohet përpjekjeve për të reduktuar emetimet dhe për të rritur mbyjtjet. Meqenëse ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis temperaturave mesatare globale dhe përqëndrimit të gazeve serrë në atmosferë, çelësi për zgjidhjen e problemit të ndryshimeve klimatike qëndron në uljen e sasisë së emetimeve të lëshuara në atmosferë dhe në uljen e përqëndrimit aktual të dioksidit të karbonit (CO₂) duke rritur mbyjtjet p.sh., duke rritur sipërfaqen e pyjeve [Përkufizimi i UNFCCC-së].



Planifikimi i Emergjencës

Një proces menaxhimi që analizon risqet nga fatkeqësitë dhe vendos marrëveshje paraprakisht për të mundësuar përgjigje në kohë, efektive dhe të përshtatshme, veprime me role dhe burime të identifikuar qartë, procese informacioni dhe marrëveshje operationale për aktorë të veçantë në kohë nevojë [Përkufizimi i UNDRR-së].



Fatkeqësia

Një ndërprerje serioze e funksionimit të një komuniteti ose një shoqërie në çdo shkallë për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit, që të çojnë në një ose më shumë nga këto: humbje dhe ndikime njerëzore, materiale, ekonomike ose mjedisore [Përkufizimi i UNDRR-së].



Baza e të Dhënave Për Humbjen Nga Fatkeqësitë

Një grup të dhënash të mbledhura në mënyrë sistematike për ndodhjen e fatkeqësive, dëmtimet, humbjet dhe ndikimet, në përputhje me kërkesat minimale të monitorimit të Kornizës Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015–2030 [Përkufizimi i UNDRR-së].



Risku nga Fatkeqësitë

Humbja e mundshme e jetës, lëndimi ose asetet e shkatërruara apo të dëmtuara që mund t'i ndodhin një sistemi, shoqërie ose komuniteti në një periudhë të caktuar kohore, e përcaktuar me gjasë si funksion i rrezikut, ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit [Përkufizimi i UNDRR-së].



Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë

Një qasje cilësore ose sasore për të përcaktuar natyrën dhe shtrirjen e riskut nga fatkeqësitë duke analizuar rreziqet e mundshme dhe duke vlerësuar kushtet ekzistuese të ekspozimit dhe cenueshmërisë që së bashku mund të dëmtojnë njerëzit, pronën, shërbimet, mjetet e jetesës dhe mjedisin nga i cili varen [Përkufizimi i UNDRR-së].



Qeverisja e Riskut nga Fatkeqësitë

Sistemi i institucioneve, mekanizmave, politikave dhe kornizave ligjore dhe rregullimeve të tjera për të udhëhequr, koordinuar dhe mbikëqyrur zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe fushat e lidhura të politikës [Përkufizimi i UNDRR-së].



Menaxhimi i Riskut nga Fatkeqësitë

Zbatimi i politikave dhe strategjive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë për të parandaluar një rrezik të ri të fatkeqësive, për të zvogëluar riskun ekzistues nga fatkeqësitë dhe për të menaxhuar riskun e mbetur, duke kontribuar në forcimin e qëndrueshmërisë dhe zvogëlimin e humbjeve nga fatkeqësitë [Përkufizimi i UNDRR-së].



Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë


Ka për qëllim parandalimin e riskut të ri nga fatkeqësitë dhe zvogëlimin e atij ekzistues dhe menaxhimin e riskut të mbetur, të cilat kontribuojnë të gjitha në forcimin e qëndrueshmërisë dhe arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Shënim: Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë është objektivi i politikës së menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë, dhe qëllimet dhe objektivat e tij përcaktohen në strategjitë dhe planet e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë [Përkufizimi i UNDRR-së].



Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm

Një sistem i integruar i monitorimit dhe parashikimit të rreziqeve, vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, sistemeve dhe proceseve të aktiviteteve të komunikimit dhe gatishmërisë që u mundëson individëve, komuniteteve dhe qeverive të ndërmarrin veprime në kohë përpara ngjarjeve të rrezikshme [Përkufizimi i UNDRR-së].



Humbja ekonomike

Ndikim ekonomik i plotë që konsiston në humbje ekonomike direkte dhe humbje ekonomike indirekte. Humbja e drejtpërdrejtë ekonomike është vlera monetare e shkatërrimit të plotë ose të pjesshëm të aseteve fizike që ekzistojnë në zonën e prekur. Kjo është pothuajse e barabartë me dëmtimin fizik. Humbja ekonomike indirekte është një rënie e vlerës ekonomike të shtuar si pasojë e humbjeve të drejtpërdrejta ekonomike dhe/ose ndikimeve njerëzore dhe mjedisore [Përkufizimi i UNDRR-së].



Fuqizimi

I referohet rritjes së fuqisë personale, politike, sociale ose ekonomike të individëve dhe komuniteteve. Fuqizimi i grave dhe vajzave ka të bëjë me gratë dhe vajzat që marrin pushtetin dhe kontrollin mbi jetën e tyre. Ai përfshin rritjen e ndërgjegjësimit, ndërtimin e vetëbesimit, zgjerimin e zgjedhjeve, rritjen e aksesit dhe kontrollit mbi burimet dhe veprimet për të transformuar strukturat dhe institucionet që përforcojnë dhe përjetësojnë diskriminimin dhe pabarazinë gjinore [UNICEF definition].




Analiza Gjinore

Një ekzaminim kritik i mënyrës sesi ndryshimet në rolet, aktivitetet, nevojat, mundësitë dhe të drejtat gjinore ndikojnë tek burrat, gratë, vajzat dhe djemtë në situata ose kontekste të caktuara. Analiza gjinore shqyrton marrëdhëniet ndërmjet femrave dhe meshkujve dhe aksesin e tyre ndaj njëri-tjetrit dhe në lidhje me njëri-tjetrin [Përkufizimi i UNICEF-it].




Dhuna me Bazë Gjinore

Dhuna me bazë gjinore (GBV) është një term ombrellë për çdo veprim të dëmshëm që kryhet kundër vullnetit të një personi dhe që bazohet në dallimet shoqërore (gjinore) midis femrave dhe meshkujve. Natyra dhe shtrirja e llojeve të veçanta të GBV-së ndryshojnë sipas kulturave, vendeve dhe rajoneve [Përkufizimi i UNICEF-it].



Barazia Gjinore

Koncepti që gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë kanë kushte, trajtim dhe mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre të plotë, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin, dhe për të kontribuar për zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe politik (dhe për të përfituar prej tij). I referohet vlerësimit të barabartë nga shoqëria të ngjashmërive dhe dallimeve të burrave dhe grave, si dhe roleve që ata luajnë. Ai bazohet në faktin se gratë dhe burrat janë partnerë të plotë në shtëpi, komunitet dhe shoqëri [Përkufizimi i UNICEF-it].



Integrimi Gjinor

Integrimi gjinor është një strategji e njohur globalisht për t'i bërë shqetësimet dhe përvojat e grave si dhe të burrave pjesë integrale të hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve [Përkufizimi i Grave të Kombeve të Bashkuara & ECOSOC-ut].



Buxhetimi që i Përgjigjet Çështjeve Gjinore

Planifikimi, programimi dhe buxhetimi i qeverisë që kontribuon në avancimin e barazisë gjinore dhe përmbushjen e të drejtave të grave. Ai përfshin identifikimin dhe pasqyrimin e ndërhyrjeve të nevojshme për të adresuar boshllëqet gjinore në politikat, planet dhe buxhetet sektoriale dhe të qeverisjes vendore [Përkufizimi i UNICEF-it].



Programimi dhe Politikat që i Përgjigjen Çështjeve Gjinore

Programet dhe politikat që u përgjigjen çështjeve gjinore përdorin qëllimisht konsideratat gjinore për të ndikuar në hartimin, zbatimin dhe rezultatet e programeve dhe politikave. Ato pasqyrojnë realitetet dhe nevojat e vajzave dhe grave, në komponentë të tillë si përzgjedhja e vendit, stafi i projektit, përmbajtja dhe monitorimi. Reagimi ndaj çështjeve gjinore identifikon dhe adreson nevojat e diferencuara të të gjitha gjinive; promovon rezultate të barabarta dhe u përgjigjet nevojave praktike dhe strategjike gjinore [Përkufizimi i UNICEF-it].



Programi dhe Politikat me Ndjeshmëri Gjinore

Programet dhe politikat e ndjeshme gjinore janë të vetëdijshme dhe adresojnë dallimet gjinore. Ato punojnë rreth dallimeve dhe pabarazive ekzistuese gjinore për të siguruar shpërndarje/ shërbime/mbështetje të barabartë në përputhje me dallimet para-ekzistuese gjinore, strukturat, sistemet dhe ndarjet e pushtetit në shoqëri [Përkufizimi i UNICEF-it].



Programimi dhe Politikat Transformuese Gjinore

Programimi dhe politikat transformuese gjinore transformojnë marrëdhëniet gjinore për të arritur barazinë gjinore. Ato përpiqen të transformojnë marrëdhëniet e pabarabarta gjinore për të promovuar pushtetin e përbashkët, kontrollin e burimeve, vendimmarrjen dhe mbështetjen për fuqizimin e të gjitha gjinive në mënyrë të barabartë [Përkufizimi i UNICEF-it].



Rreziku

Një proces, fenomen ose aktivitet njerëzor që mund të shkaktojë humbje jete, lëndime ose ndikime të tjera shëndetësore, dëmtime pronësore, përçarje sociale dhe ekonomike ose degradim mjedisor.

Shënim: Rreziqet mund të jenë me origjinë natyrore, antropogjene ose social-natyrore. Rreziqet natyrore janë kryesisht të lidhura me proceset dhe fenomenet natyrore [Përkufizimi i UNDRR-së].




Përfshirja & Përfshirja Sociale

Një proces ku bëhen përpjekje për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë, pavarësisht nga prejdardhja e tyre, në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë në jetë. Është një proces shumëdimensional që synon krijimin e kushteve që mundësojnë pjesëmarrjen e plotë dhe aktive të çdo anëtari të shoqërisë në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë aktivitetet qytetare, sociale, ekonomike dhe politike, si dhe pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse [Përkufizimi i UNDESA-s].




Ndërsektorialiteti

Ndërsektorialiteti pranon se jetët e njerëzve formohen nga identitetet, marrëdhëniet dhe faktorët socialë të tyre. Këto kombinohen për të krijuar forma ndërthurëse të privilegjit dhe shtypjes në varësi të kontekstit të një personi dhe strukturave ekzistuese të pushtetit si patriarkalizmi, ableizmi, kolonializmi, imperializmi, homofobia dhe racizmi [Përkufizimi i Grave të Kombeve të Bashkuara].



Zbutja

Zvogëlimi ose minimizimi i ndikimeve të kundërta të një ngjarjeje të rrezikshme. Masat zbutëse përfshijnë teknika inxhinierike dhe ndërtime rezistente ndaj rreziqeve, si dhe politika mjedisore dhe sociale të përmirësuara dhe ndërgjegjësim publik [Përkufizimi i UNDRR-së].



Platforma Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë

Një term i përgjithshëm për mekanizmat kombëtarë për koordinimin dhe udhëzimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë që janë shumë sektoriale dhe ndërdisiplinore në natyrë, me pjesëmarrjen publike, private dhe të shoqërisë civile që përfshin të gjitha entitetet e interesuara brenda një vendi [Përkufizimi i UNDRR-së].



Personat me Aftësi të Kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara duke përfshirë ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat në ndërveprim me pengesa të ndryshme qëndrimore dhe mjedisore pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët. Një person me aftësi të kufizuara mund të konsiderohet si një person me një aftësi të kufizuar në një shoqëri ose mjedis, por jo në një tjetër, në varësi të rolit që personi supozohet të marrë në komunitetin e tij ose të saj. Perceptimi dhe realiteti i aftësisë së kufizuar varet gjithashtu nga teknologjitë, asistencat dhe shërbimet e disponueshme, si dhe nga konsideratat kulturore [Përkufizimi i UNDRR-së].




Gatishmëria

Njohuritë dhe kapacitetet e zhvilluara nga qeveritë, organizatat e reagimit dhe rimëkëmbjes, komunitetet dhe individët për të parashikuar, përgjigjur dhe rikuperuar në mënyrë efektive nga ndikimet e fatkeqësive të mundshme, të afërta ose aktuale [Përkufizimi i UNDRR-së].



Rimëkëmbja

Rivendosja ose përmirësimi i mjeteve të jetesës dhe shëndetit, si dhe i aseteve, sistemeve dhe aktiviteteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore, të një komuniteti ose shoqërie të prekur nga fatkeqësitë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të "rindërtimit më të mirë", për të shmangur ose zvogëluar riskun e fatkeqësive në të ardhmen [Përkufizimi i UNDRR-së].



Resistenca/ Qëndrueshmëria

Aftësia e një sistemi, komuniteti ose shoqërie të ekspozuar ndaj rreziqeve për të rezistuar, thithur, akomoduar, përshtatur, transformuar dhe rikuperuar nga efektet e një rreziku në kohën e duhur dhe me një mënyrë efikase, duke përfshirë ruajtjen dhe restaurimin e strukturave të tij themelore dhe funksionet nëpërmjet menaxhimit të riskut [Përkufizimi i UNDRR-së].

Përgjigja/Reagimi

Veprimet e ndërmarra drejtpërdrejt përpara, gjatë ose menjëherë pas një katastrofe për të shpëtuar jetë, për të reduktuar ndikimet në shëndet, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore të jetesës së njerëzve të prekur.



Shënim: Përgjigja ose reagimi ndaj fatkeqësive përqëndrohet kryesisht tek nevojat e menjëhershme dhe afatshkurtra dhe nganjëherë quhet ndihmë në rast fatkeqësie. Reagimi efektiv, efikas dhe në kohë mbështetet në masat e gatishmërisë që informojnë për riskun nga fatkeqësitë, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve të reagimit të individëve, komuniteteve, organizatave, vendeve dhe komunitetit ndërkombëtar. [Përkufizimi i UNDRR-së].

Të Dhëna të Ndara Sipas Gjinisë, Moshës dhe Aftësisë së Kufizuar

E shkurtuar si SADDD, i referohet të dhënave që ndahen në kategori të ndryshme. Kjo mund të jetë një ose të gjitha kategoritë -- gjinia, moshë dhe aftësia e kufizuar. Përdorimi i SADDD-it mund të tregojë ndryshimet dhe pabarazitë e kushteve për grupe të ndryshme të popullsisë [Përkufizimi i Kombeve të Bashkuara].



Cenueshmëria

Kushtet e përcaktuara nga faktorët ose proceset fizike, sociale, ekonomike dhe mjedisore që ekspozojnë individët dhe komunitetet dhe asetet e tyre ndaj ndikimeve të rreziqeve [Përkufizimi i UNDRR-së].



Sekretariati i OSBE-së

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Programi për Çështjet Gjinore

Wallnerstrasse 6

1010 Vjenë

E-mail: equality@osce.org

www.osce.org/secretariat/gender

 Organization for Security and
Co-operation in Europe

Ky botim është pjesë e projektit të Sekretariatit të OSBE-së WIN – Gratë dhe Burrat Inovativë për Barazinë Gjinore.

Projekti WIN zbatohet me mbështetjen e donatorëve të mëposhtëm:



Norwegian Ministry
of Foreign Affairs



Ministry of Foreign Affairs of the
Netherlands



An Roinn Gnóthaí Eachtracha
Department of Foreign Affairs



GOBIERNO
DE ESPAÑA
MINISTERIO
DE ASUNTOS EXTERIORES, UNIÓN EUROPEA
Y COOPERACIÓN



Government Offices of Sweden